



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.6.	RREZIQET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
Nën-tema 2.6.2.	ELEKTRICITETI
Ligji / rregulloret përkatëse:	<ul style="list-style-type: none">● Ligji Nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;● Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës;● Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;● Rregullore (MPMS) Nr.08/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me fushat elektromagnetike në vendin e punës;● CEI EN 50110 – Operimi i instalimeve elektrike;● ISO 45001 – Sistemet e menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;● BS EN 62305-1:2011 – Mbrojtja nga rrufeja.
Shkurtesat:	<ul style="list-style-type: none">● MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale● PPM – Pajisjet Personale Mbrojtëse● SSHP – Siguria dhe Shëndeti në Punë● RCD – Pajisje për Matjen e Rrymës së Mbetur● ILO – Organizata Botërore e Punës● CEI EN – Komiteti Italian i Elektroteknikës Normativa Evropiane● ISO – Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit

	<ul style="list-style-type: none"> • BS EN – Standard Britanik Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr. 04 / L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsyet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të energjisë elektrike, pajisjeve elektrike ose instalimit elektrik.
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.


Nr.	Pika e kontrollit	Po	Jo	Vërejtje për zbatim
	INSPEKTIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE DHE VENDPUNIMEVE ELEKTRIKE PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<ul style="list-style-type: none"> * <i>Bëhuni shembull; respektoni rregulloret e shëndetit dhe sigurisë në lokacionin / vendet e inspektuara të punës.</i> * <i>Gjatë vizitës në terren / vendin e punës kushtojini vëmendje aspekteve të përgjithshme ose organizimit të punës dhe proceseve duke përfshirë organizimin vendeve të punës dhe mjedisit përreth përfshirë këtu cilësinë e instalimeve elektrike, ndriçimin dhe mikroklimën që mund të ketë efekt në punën e sigurt me energji elektrike.</i> * <i>Merrni shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të vendpunishteve dhe mjediseve përreth (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë).</i> * <i>Mbani mend:</i> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Kushtojini vëmendje shprehive të punës kur punëtorët punojnë pranë objekteve elektrike, me pajisje elektrike ose instalime elektrike.</i> ○ <i>Pyesni disa nga punonjësit për informacionet që i posedojnë në lidhje me rreziqet dhe masat parandaluese për rrezikun e energjisë elektrike në lidhje me aksidentet në punë.</i> 			
	KONTROLLIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË			
	<ul style="list-style-type: none"> * <i>Në rast, nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit SSHP ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me atë.</i> 			

	<i>* Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.</i>			
1.	A është kryer vlerësimi i detajuar i riskut për vendet e punës që lidhen me elektricitet? Ligji Nr.04/ L-161, Neni 5 pika 3 dhe Neni 16 Rregullore (MPMS) Nr.02/2021			
2.	A janë trajnuar të punësuarit për të punuar në mënyrë të sigurt me elektricitet? Ligji Nr.04/ L-161, Neni 6 pika 1 dhe Neni 20			
3.	A mbahen pajisjet e punës (pajisjet elektrike) në gjendje të mirë, të kontrollohen në afatet e parashikuara për funksionalitetin dhe sigurinë e tyre? Ligji Nr.04/ L-161, Neni 14			
4.	A janë trajnuar të punësuarit në lidhje me përdorimin e PPM-ve për mbrojtje nga rreziqet elektrike? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 8, 3			
5.	A janë konsultuar punonjësit ose përfaqësuesit e tyre për përzgjedhjen, sigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e PPM-ve për mbrojtje nga rreziqet elektrike? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 8, 4			
MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDIT TË PUNËS				
6.	A janë të gjitha pajisjet e punës të pajisura me mjete për ndërprerjen e furnizimit të tyre nga të gjitha burimet e energjisë elektrike, të cilat janë qartësisht të dallueshme? Rregullore (MPMS) Nr.05/2014, Shtojca I, 2.14 dhe 2.13			

	<ul style="list-style-type: none"> ● <i>Ri-kyçja duhet të supozohet se nuk paraqet rrezik për punëtorin në fjalë.</i> ● <i>Izolimi i pajisjeve duhet të kontrollohet para se të kyçen në burimin e energjisë (p.sh. lista e kontrollit për inspektimin e pajisjeve, testimi i pajisjeve etj.).</i> 			
7.	<p>A janë të gjitha pajisjet e punës të përshtatshme për mbrojtjen e punëtorëve të ekspozuar nga rreziku i kontaktit direkt (drejtpërdrejt) apo indirekt (të tërthortë) me energji elektrike?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.05/2014, Shtojca I, 2.19</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Izolimi i pajisjeve duhet të kontrollohet para se të kyçen në burimin e energjisë (p.sh. lista e kontrollit për inspektimin e pajisjeve, testimi i pajisjeve, etj.).</i> 			
8.	<p>A janë projektuar dhe ndërtuar instalimet elektrike asisoj që nuk përbëjnë rrezik për zjarr apo shpërthim?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr. 01/2020, Neni 6</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni gjetjet më të fundit të testimit të sigurisë së instalimit, nëse rezultatet tregojnë ndonjë rrezik të mundshëm nga zjarri ose shpërthimi.</i> ● <i>Mbani mend nëse ndonjë nga testet e kryera (p.sh. tensioni dhe frekuenca, testi i vazhdimësisë, testi i rezistencës së izolimit, testi i rezistencës së tokëzimit, testi RCD, rënia e tensionit për ndonjë pjesë të instalimit elektrik etj.), tregon vlera jashtë normave teknike, instalimi duhet të ri-testohet.</i> 			
9.	<p>A janë të punësuarit dhe personat e tjerë të mbrojtur në mënyrën e duhur nga kontakti direkt (drejtpërdrejtë) ose indirekt ((të tërthortë) me energjinë elektrike për shkak të rreziqeve që mund të shkaktojnë lëndime?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 6</p>			

10.	<p>A operohet në vendin e punës me pajisje që mund të dërgojnë deri në kontakt me linjat ajrore të energjisë elektrike?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.02/2020 dhe 05/2014 Kryerja e inspektimeve të punës në ndërtimtari, udhëzuesi ILO, 3.3.4.5</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>A ka në operim vinça dhe pajisje të tjera ngritëse?</i> ● <i>A ka kamionë me rimorkio / kontejner ngritës?</i> ● <i>A ka ekskavatorë dhe pajisje të tjera që shkaktajnë lëvizje (dridhje) në tokë?;</i> ● <i>A ka trajtim të sendeve të gjata si tubat e skelave, panele metalike, shkallë, etj.?</i> ● <i>Kontrolloni nëse puna mund të kryhet larg nga linjat e energjisë elektrike. Nëse pikat e lartshënuara nuk janë të mundura, atëherë kontrolloni nëse janë bërë të gjitha përpjekjet për t'i bërë linjat pa tension, d.m.th. të ndërprisni energjinë elektrike. (P.sh. duke paraqitur paraprakisht një kërkesë për ndërprerje në kompaninë e shërbimeve të shpërndarjes së energjisë elektrike).</i> 			
11.	<p>A janë lokalizuar dhe shënuar kabllot e fshehura të energjisë elektrike dhe kabllot nëntokësore, dhe a janë marrë masa paraprake për punë të sigurt?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 Kryerja e inspektimeve të punës në ndërtimtari, udhëzuesi ILO, shtojca 1</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse ka kabllot të tilla nëpërmjet një lokalizuesi të kabllave</i> ● <i>A janë përcaktuar distanca të sigurt gjatë punës me/afër kabllave të tilla?</i> ● <i>A janë mbuluar kanalet kabllore në zonën e punës?</i> 			
12.	<p>A është projektimi, ndërtimi dhe zgjedhja e materialit dhe pajisjeve mbrojtëse për instalimet elektrike e përshtatshme për tensionin?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 6</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse projektimi i instalimit elektrik korrespondon me tensionin e operimit.</i> ● <i>Kontrolloni nëse materiali i instalimit elektrik korrespondon me tensionin e operimit.</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse konstruksioni i instalimit elektrik korrespondon me tensionin e operimit.</i> 			
13.	<p>A është projektimi, ndërtimi dhe zgjedhja e materialit dhe pajisjeve mbrojtëse për instalimet elektrike e përshtatshme për kushtet e jashtme?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 6</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse instalimi elektrik përmban tokëzimin e duhur.</i> 			
14.	<p>A është projektimi, ndërtimi dhe përzgjedhja e materialit dhe pajisjeve mbrojtëse për instalimet elektrike e përshtatshme për kompetencën e personave që kanë qasje në pjesët e instalimit?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 6</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse personeli që ka qasje në instalimet elektrike është i kualifikuar dhe kompetent.</i> 			
15.	<p>A janë zgjedhur masat e duhura për mbrojtjen nga rrufeja në vendin e punës (ndërtesë, objekt, impiant etj.)?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 5 dhe 6 BS EN 62305-1:2011, 7</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse ekzistojnë masa për të zvogëluar dëmtimin e qenieve të gjalla nga goditja elektrike.</i> • <i>Kontrolloni nëse ekzistojnë masa për të zvogëluar dëmtimin fizik.</i> • <i>Kontrolloni nëse ekzistojnë masa për të zvogëluar dështimin e sistemeve elektrike dhe elektronike.</i> 			
16.	<p>A ka masa të ndërmarra për të shmangur rreziqet nga fushat elektromagnetike (që vijnë nga elementët e sistemit elektroenergjetik) në vendin e punës?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 7, 3</p>			

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse janë ndërmarrë masa teknike për të shmangur rreziqet që mund të ketë fusha magnetike e një linje ajrore ose nëntokësore, makine elektrike ose instalimi elektrik, p.sh. bllokuesit ose sistemet e ekranizimit.</i> 			
17.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të vendosur të shenjave paralajmëruese të rrezikut nga elektriciteti?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p> <div style="text-align: center;">  <p><i>Rrezik elektriciteti</i></p> </div> <p><i>* "Shenja paralajmëruese" do të thotë një shenjë sigurie për të treguar vendet ose situatat e rrezikshme. Këto shenja të shëndetit dhe sigurisë kërkohet të jenë të verdha. Një shembull është një shenjë sigurie që specifikon rrezikun e energjisë elektrike. Ndërsa ecni nëpër vendin e punës, kushtojini vëmendje të gjitha vendeve ku duhet të vendosen shenja të tilla. Diskutoni me punëtorët se çfarë nënkuptojnë shenjat e sigurisë!</i></p>			
18.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të vendosur të shenjave të ndalimit të cilat e ndalojnë qasjen për persona të paautorizuar (p.sh. objektet energjetike, makineritë elektrike, pajisjet elektrike, instalimi elektrik etj.)?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p>			



Ndalohet qasja për persona të paautorizuar

** "Shenja e ndalimit" nënkupton një shenjë sigurie që ndalon sjelljen që mund të shkaktojë rrezik për shëndetin ose sigurinë. Një shenjë e ndalimit do të tregojë vetëm çka ose kush është e ndaluar. Ndërsa ecni nëpër vendin e punës, kushtojini vëmendje të gjitha vendeve ku duhet të vendosen shenja të tilla. Diskutoni me punëtorët se çfarë nënkuptojnë shenjat e sigurisë!*

19.	A janë ofruar Pajisje Personale Mbrojtëse për të punësuarit për mbrojtje nga rreziqet elektrike në vendin e punës mbi bazën e vlerësimit të riskut për punët që kanë të bëjnë me energjinë elektrike? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5			
20.	A janë furnizuar me mbrojtjen e kokës punëtorët që kryejë punë që kanë të bëjnë me energjinë elektrike nga kontakti me elektricitetin? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Shtojca II, 1, 1.1			
21.	A janë furnizuar të punësuarit që kryejë punë që kanë të bëjnë me energjinë elektrike me mbrojtje të duarve dhe krahëve nga kontakti me elektricitetin? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Shtojca I, 5, 5.1.3			

22.	<p>A janë furnizuar të punësuarit që kryejë punë që kanë të bëjnë me energjinë elektrike me mbrojtje të shputave dhe këmbëve nga kontakti me elektricitetin?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Shtojca I, 6, 6.8 dhe 6.9</p>			
23.	<p>A janë pajisur të punësuarit me mbrojtje të syve ose fytyrës kur janë potencialisht të ekspozuar ndaj punës me nxehtësi rrezatuese?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Shtojca II, 3, 3.1.12</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse punonjësit që mund të jenë të ekspozuar ndaj harkut elektrik janë të pajisur me këtë lloj të mbrojtjes.</i> 			
24.	<p>Në objektet elektroenergjetike (nënstacione, trafo stacione, stabilimente shpërndarëse, panele elektrike, kuadro kryesore kyçëse apo shpërndarëse, etj.) a janë ndërmarrë masat e nevojshme dhe vendosur udhëzime për ndihmën e parë (në rast të kontaktit me energji elektrike), fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve, si dhe a ka qasje tek daljet emergjente?</p> <p>Ligji Nr.04/ L-161, Neni 11 Rregullore (MPMS) Nr. 01/2020, Neni 3 ISO 45001</p>			
25.	<p>Në objektet elektroenergjetike (nënstacione, trafo stacione, stabilimente shpërndarëse, panele elektrike, kuadro kryesore kyçëse apo shpërndarëse, etj.) a ka skemë një-polëshe, si dhe konfiguracioni ekzistues i sistemit elektroenergjetik a është i ngjashëm me skemën njëpolare?</p> <p>CEI EN 50110-1, 4.7</p>			
26.	<p>Në objektet elektroenergjetike (nënstacione, trafo stacione, stabilimente shpërndarëse, panele elektrike, kuadro kryesore kyçëse apo shpërndarëse, etj.) a janë të vendosura udhëzime për manovrim/operim/manipulim me</p>			

	<p>pajisjet elektroenergjetike, si dhe a ekzistojnë emrat/numrat në çeli/kthina?</p> <p>CEI EN 50110-1, 6.1</p>			
27.	<p>Në objektet elektroenergjetike (nënstacione, trafo stacione, stabilimente shpërndarëse, panele elektrike, kuadro kryesore kyçëse apo shpërndarëse, etj.) a është transformatori, gjeneratori, motori, etj., në një vend të sigurt?</p> <p>CEI EN 50110-1, 6.2.4.1, 6.3.6</p> <ul style="list-style-type: none"> ● A është makineria/pajisja e tokëzuar? ● A është duke u mirëmbajtur makineria/ pajisja në baza të rregullta dhe sipas udhëzimeve në bazë të manualeve/specifikimet teknike të pajisjes? 			